



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranim / Dorezuar Prilbjen / Prilbjen Received / Delivered	09 - 11 2023	3	vit and year
Organ / Njësia Org / Unit	SKN/MSH/6954/2023	Shtojca Protig Appendix	Sasia Këmbena Quantity
			115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A nr. 1194/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malore Gashi – Bajraktari, dhe Ardita Haxhnikaj - Demi, anëtarë me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr. 1194/2023 të datës 22.09.2023 të parashtruar nga ankueses

kundër Komunës së Suharekës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.11.2023, mori këtë.

**V E N D I M**

**I. REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 1194/2023 e datës 22.09.2023 e parashtruar nga ankuesja

**II. MBETET NË FUQI**, Vendimi me numër protokolli 01- Nr- 016-59889 i datës 06.09.2023, i Komisionit për Vlerësimin i Komunës së Suharekës.

**A r s y e t i m**

Ankuesja (tani e tutje referuar si ankuesja), me datë 22.09.2023 me numër protokolli 6188/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për Specialist i Përgjithshëm i Shkencave Politike, për pozitën „ Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1“, në Qendrën për Punësim dhe Shërbime Sociale, si dhe kundër Vendimit të datës 06.09.2023, me numër protokolli 01-Nr- 01-59889, të Komisionit për Vlerësim të Komunës së Suharekës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Suharekës. Ndërsa me datë 29.09.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 1194/2023, e datës 22.09.2023, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër protokollit 01-Nr -016-59889, i Komisionit për Vlerësim; Ankesë e datës 01.09.2023, drejtuar Komisionit të Pranimit; Rezultatet e vlerësimit të datës 30.08.2023; cv e ankueses [redacted] Diplomë me numër protokollit Nr. 573/1017, e datës 10.03.2017; Diplomë me numër protokollit Nr. 145/0612, e datës 03.02.2010; Diplomë e datës 30.05.2005; Marrëveshja për praktikë e datës 05.03.2012; Referencë me numër protokollit 221 e datës 23.10.2012; Kontratë e marrëdhënies së Punës e datës 17.09.2012; Marrëveshje për shërbime të veçanta me numër protokollit 01-Nr- 16-1758, e datës 07.03.2013; Marrëveshje për shërbime të veçanta me numër protokollit 01-Nr- 16-6903, e datës 11.09.2013; Kontratë e marrëdhënies së Punës e datës 01.05.2017; Marrëveshje për praktikë me numër protokollit Nr. 02-Nr-113-3344; dëshmi nga trusti për periudhën nga data 26.06.2009, deri me datën 27.04.2022; Konkursi i datës 18.05.2023; Autorizim me numër protokollit 01-Nr-016-30881, i Kryetarit të Komunës së Suharekës; Njoftimi me numër protokollit 01-Nr-016-32038, i datës 18.05.2023; Lista e kandidatëve në pritje; Vendimi me numër protokollit 01-Nr- 410-42682, i datës 10.07.2023, për Formimin e Komisionit Intervistues; Formulari i Vlerësimit për Kriteret e zgjedhjes së ngushtë; Testimi me gojë; Formuari për vlerësimin individual i kandidatëve për vendin e punës për [redacted] Procesverbal me numër protokollit 01-035-54753; Formulari për vlerësimin individual të Jetëshkrimit; Formuari për vlerësimin individual i kandidatëve për vendin e punës për [redacted] Procesverbal me numër protokollit 01-035-54753, i datës 18.08.2023; Njoftimi me numër protokollit 01-016399048, i datës 27.06.2023; Njoftimi për vlerësimin e rezultateve përfundimtar me numër protokollit 01-016-40797, i datës 03.07.2023; Rezultatet e Vlerësimit me numër protokollit 01-016-58547, i datës 30.08.2023; Renditja përfundimtare e Kandidatëve; Aplikacioni i [redacted] me shkresat e bashkangjitura për [redacted] me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokollit 145/0615, e datës 03.02.2010; Diplomë me numër protokollit 573/1017, e datës 10.03.2017; Dëshmi nga trusti për periudhën nga data 26.06.2009, deri me datën 27.04.2022; Marrëveshje për praktikantë e datës 05.03.2012; Referencë me numër protokollit 221, e datës 23.10.2012; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 17.09.2012; Kontratë e marrëdhënies së Punës e datës 17.09.2012; Marrëveshje për shërbime të veçanta me numër protokollit 01-Nr- 16-1758, e datës 07.03.2013; Marrëveshje për shërbime të veçanta me numër protokollit 01-Nr- 16-6903, e datës 11.09.2013; Kontratë e marrëdhënies së Punës e datës 01.05.2017; Marrëveshje për praktikë me numër protokollit Nr. 02-Nr-113-3344; dëshmi nga trusti për periudhën nga data 26.06.2009, deri me datën 27.04.2022; Certifikatë e datës 13.06.2023; Aplikacioni i [redacted] me shkresat e bashkangjitura për [redacted] me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e datës 15.06.2023; Diplomë me numër protokollit 1954, i datës 09.11.2018; Diplomë me numër 547/16, i datës 07.07.2016; Certifikatë e datës 18.12.2002; Certifikatë e datës 12-13 e muajit maj të vitit 2022; Dëshmi nga trusti për periudhën nga data 21.04.2008, deri me datën 26.01.2023; Kontrata për shërbim e datës 04.02.2008; Kontratë e punës për



punë dhe detyrat Specifike e datës 01.12.2010; Kontratë e punës e datës 08.09.2021; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 1194/2023, e datës 29.09.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se Komuna e Suharekës, me datë 18.05.2023 (afati për aplikim 08.06.2023 -22.06.2023) ka shpallur konkursin për Specialist i Përgjithshëm i Shkencave Politike, për pozitën „ Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1”, në Qendrën pe Punësim dhe Shërbime Sociale në Komunën e Suharekës, me numër të referencës RN00011687. Rrjedhimisht, sipas Vendimit me numër protokolli 01-nr. -016-59889, të datës 06.09.2023, rezulton se ankues i është refuzuar ankesa si e pa bazuar duke e lenë në fuqi Njoftimin 01 nr. -01658547, të datës 30.08.2023, për përfundimin e testimit me shkrim vlerësimit të jetëshkrimit (CV) dhe intervistës me gojë. Ankuesja e pakënaqur me Vendimin 01-nr. -016-59889, të datës 06.09.2023, me datë me datë 22.09.2023 me numër protokolli 6188/2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore analizoi kriteret e konkursit për pozitën përkatëse të punës dhe për pasojë konstatoi se kriteret formale për pozitën e punës “Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1”, në Qendrën pe Punësim dhe Shërbime Sociale në Komunën e Suharekës, me numër të referencës RN00011687, kanë qenë:

- Arsimi i kërkuar diplome e arsimit të lartë; Fakulteti Shkenca Politike, Administratë Publike, Politika Sociale/ Juridik
- Pa përvoje punë

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar së pas zhvillimit të procedurave të rekrutimit, Komisioni për Vlerësimin, si kandidates së suksesshme për pozitën për Specialist i Përgjithshëm i Shkencave Politike, për pozitën „ Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1”, në Qendrën pe Punësim dhe Shërbime Sociale nga Komuna e Suharekës, e ka rekomanduar kandidaten [redacted] të cilën e ka vlerësuar në gjithë jetë tetëdhjetë e pese pikë katër (85.4), pikë andaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar së Komisioni për Vlerësimin, në rastrin e rekomandimit të kandidates ka vepruar në pajtim nenin 6, paragrafi 1, të Ligjit NR. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë, ku thuhet se; 1. Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive, si dhe në pajtim me nenin 4, paragrafi 1.2 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet; 1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional



gjinator dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se nga shkresat e lëndes del se kandidatja e përzgjedhur [redacted] në bazë të diplomës me numër 547/16, të datës 07.07.2016, të lëshuar nga Kolegji AAB, me datë 01.07.2016, ka të kryer LLB në Juridik, si dhe në bazë të diplomës me numër 1420, të datës 19.12.2017, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", ka të kryer Master në drejtimin Financiar.

Nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore të ankueses Albulena Gashi, e cila pretendon së Komisioni rekrutues lidhur me përvojën e punës e ka vlerësuar me zero pikë, kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse në konkursin e shpallur me datë 18.05.2023, për pozitën „ për Specialist i Përgjithshëm i Shkencave Politike, për pozitën „Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1“, në Qendrën për Punësim dhe Shërbime Sociale, nga Komuna e Suharekës, kriteret formale të konkursit sa i përket përvojës së punës kanë qenë :Pa përvoje punë, ndërsa të trajnimet ankuesja është vlerësuar me zero, pikë pasi që ankuesja nuk ka ofruar dëshmi lidhur me trajnimet, prandaj mbi bazën e kësaj kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses sa i përket vlerësimit të jetëshkrimit nga Komisioni rekrutues janë të pa bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni i Vlerësimit i Komunës së Suharekës me rastin e nxjerrjes së Vendimi 01-Nr- 016-599889 të datës 06.09.2023, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit NR. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, lidhur me ankesën e ankueses [redacted] për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për Specialist i Përgjithshëm i Shkencave Politike, për pozitën „ Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1“, në Qendrën për Punësim dhe Shërbime Sociale, nga Komuna e Suharekës.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të gjitha provave dhe fakteve relevante, që nga inicimi i procedurës së rekrutimit deri të përzgjedhjen e kandidatës për pozitën për pozitën „ Zyrtar për Mirëqenie Sociale 1“, në Qendrën për Punësim dhe Shërbime Sociale, nga Komuna e Suharekës, ka vepruar në përputhje me Ligjin, NR. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr. 1194/2023*

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Suharekës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.